

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

**SHËRBIME KUJDESI PËR
FËMIJË**

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor
”Shërbime sociale dhe shëndetësore”)

Kodi: O2-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.
- III. Plani mësimor për profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e kujdesit për fëmijë”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të respektojë etikën profesionale të kujdestarit për fëmijë.
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor për fëmijë.
- Të zbatojë parimet e garantimit të të drejtave të njeriut.
- Të komunikojë me individë të moshës femërore sipas rregullave specifike të komunikimit.
- Të sillet me etikë dhe profesionalizëm gjatë përkujdesjes për fëmijë sipas rregullave specifike.
- Të përkujdeset për fëmijët në infeksionet infektive dhe parazitare.
- Të përkujdeset për fëmijët e sëmurë.
- Të përkujdeset gjatë dhënies së medikamenteve në rrugë të ndryshme.
- Të përkujdeset për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës.
- Të përkujdeset për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit të fëmija.
- Të përkujdeset për zhvillimin e orientimit të fëmijës në hapësirë dhe në kohë.
- Të përkujdeset për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijës nëpërmjet shqisave.
- Të zbatojë standardet e profesionit të kujdestarit për fëmijë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli

III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në qendra rezidenciale ose ditore për fëmijë, në shërbimet komunitare të përkuqdesjes, në spitale, për t'u vetëpunësuar si kujdestar për fëmijë ose, mbas një përvoje pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijë.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-21-306-20	Pediatria e përgjithshme	2
3	L-20-307-20	Psikologji pediatrike	3
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-21-876-20	Përkuqdesja ndaj fëmijës për orientimin e tij në hapësirë dhe në kohë	51
2	M-20-874-20	Përkuqdesja për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës	51
3	M-20-878-20	Përkuqdesja për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit të fëmija	51
4	M-21-1645-20	Përkuqdesja ndaj fëmijës së sëmurë	87
5	M-21-1646-20	Përkuqdesja gjatë dhënies së medikamenteve në rrugë të ndryshme.	84
6	M-21-1647-20	Përkuqdesja ndaj fëmijës me sëmundje infektive dhe parazitare.	84
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)

1	M-20-879-20	Ndihma ndaj fëmijës gjatë procesit të të mësuarit	51
2	M-20-875-20	Përkujdesja për motoricitetin e përgjithshëm, skemën trupore dhe motoricitetin fin të fëmijës.	51
	M-20-877-20	Përkujdesja për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijës nëpërmjet shqisave	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimit e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Metoda e simulimit* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale të kujdestarit për fëmijë në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e Shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijët, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II i KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë

Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Pediatria e përgjithshme” (L-21-306-20). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Pediatria e përgjithshme”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pediatria e përgjithshme”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë objektin dhe qëllimin e shkencave mjekësore që merren me studimin e fëmijës nga lindja deri në pubertet.
- Të përkufizojnë bazat biologjike të trashëgimisë, anomalitë strukturore dhe sëmundjet gjenetike.
- Të përshkruajnë treguesit demografikë, mortalitetin infantil, rritjen dhe zhvillimin fizik dhe nevojat ushqimore të fëmijës
- Të përshkruajnë ekzaminimin fizik të të porsalindurit, keqformimet e lindura dhe ikterin e neonatit
- Të përllorarit medikamentet që përdoren në moshën pediatrike.
- Të shpjegojnë çrregullimet e sistemit tretës.
- Të shpjegojnë sëmundjet e sistemit respirator.
- Të shpjegojnë sëmundjet e sistemit kardio-vaskular.
- Të shpjegojnë sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike.
- Të shpjegojnë sëmundjet e gjëndrave endokrine.
- Të shpjegojnë sëmundjet e aparatit urinar.
- Të shpjegojnë sëmundjet e sistemit nervor.
- Të shpjegojnë sëmundjet alergjike.
- Të shpjegojnë sëmundjet infektive, infeksionet parazitare.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pediatria e përgjithshme”, kl. 12- 68 orë:

Tema 1	Bazat biologjike të trashëgimisë	5 orë
Tema 2	Puerikultura. Treguesit demografik.	5 orë
Tema 3	Ekzaminimi fizik tek i porsalinduri	5 orë
Tema 4	Përlloraritja e medikamenteve në moshën pediatrike	4 orë
Tema 5	Çrregullimet e sistemit tretës	5 orë
Tema 6	Sëmundjet e sistemit respirator	5 orë
Tema 6	Sëmundjet e sistemit kardio-vaskular.	5 orë
Tema 7	Sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike.	5 orë

Tema 8	Sëmundjet e gjëndrave endokrine.	5 orë
Tema 9	Sëmundjet e aparatit urinar.	5 orë
Tema 10	Sëmundjet e sistemit nervor.	4 orë
Tema 11	Sëmundjet alergjike.	6 orë
Tema 12	Sëmundjet infektive.	5 orë
Tema 13	Infeksionet parazitare.	4 orë

3. Lënda “Psikologji pediatrike” (L-20-307-20). Kl. 12 – 102 orë

- **Synimet e lëndës “Psikologji pediatrike”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Psikologji pediatrike”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë zhvillimin motorik të fëmijës.
- Të shpjegojnë zhvillimin kognitiv tek fëmijët.
- Të përshkruajnë zhvillimin sensitiv-motorik dhe shoqëror të fëmijës.
- Të përshkruajnë zhvillimin emocional të fëmijës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e lojrave formuese në zhvillimin e fëmijës.
- Të përshkruajnë aftësitë komunikuese verbale të fëmijës.
- Të përshkruajnë procesin e zhvillimit të aftësive të shkrimit dhe të leximit të fëmijët.
- Të përshkruajnë procesin e zhvillimit të të menduarit logjik dhe të aftësive matematikore.
- Të shpjegojnë zhvillimin e aftësive artistike dhe shkencore të fëmijës.
- Të përshkruajnë procesin e të menduarit dhe të përpunimit të informacionit të fëmijët.
- Të identifikojnë problemet psiko-sociale tek fëmijët me çrregullime të spektrit të autizmit.
- Të përshkruajnë zhvillimin e aftësisë për zgjidhjen e problemeve dhe të të menduarit kritik të fëmijët.
- Të përshkruajnë metodat e menaxhimit të konflikteve gjatë punës në grup me fëmijët.
- Të shpjegojnë rëndësinë e motivimit në arritjet dhe sukseset e fëmijës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Psikologji pediatrike”, kl.12- 102 orë**

Tema 1	Zhvillimi motorik i fëmijës	12 6 orë
Tema 2	Zhvillimi kognitiv tek fëmijët	6 orë
Tema 3	Zhvillimi shoqëror i fëmijës	12 6 orë
Tema 4	Zhvillimi emocional i fëmijës	6 orë
Tema 5	Lojrat formuese	9 orë
Tema 6	Komunikimi verbal të fëmijët	5 orë
Tema 7	Të lexuarit dhe të shkruarit të fëmijët	10 orë
Tema 8	Logjika dhe të menduarit të fëmija.	12 6 orë
Tema 9	Zhvillimi i aftësive artistike dhe shkencore të fëmijët	10 orë
Tema 10	Procesi i të menduarit të fëmija dhe përpunimi i informacionit	10 orë
Tema 11	Problemet psiko-sociale tek fëmijët me çrregullime të spektrit të autizmit	6 orë
Tema 12	Zgjidhja e problemeve dhe të menduarit kritik të fëmijët	10 orë
Tema 13	Menaxhimi i konflikteve	6 orë
Tema 14	Motivimi	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Përkujdesja ndaj fëmijës për orientimin e tij në hapësirë dhe në kohë”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	PËRKUJDESJA NDAJ FËMIJËS PËR ORIENTIMIN E TIJ NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	M-21-876-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të ushtruar fëmijën të orientohet në hapësirë, në kohë dhe me ritmin, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin në hapësirë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për motorocitetin fin.– të përzgjedhë mjetet e duhura për ushtrimin e fëmijës për orientimin në hapësirë.– të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.– të ushtrojë fëmijën për imitimim e lëvizjeve të të rriturve.– të ushtrojë fëmijën për zhvendosjen në dhomë sipas udhëzimeve që i jepen me gojë.– të përkujdeset për realizimin nga fëmija të një udhëzuesi me terma kryesore që lidhen me hapësirën (mbi, nën etj).– të përkujdeset për ndjekjen nga fëmija e një itinerari të thjeshtë, në mënyrë grafike (bashkon pikat etj).– të ushtrojë fëmijën për pozicionimin në mënyrë korrekte të objekteve mbi një sipërfaqe (puna në pasqyrë).– të ushtrojë fëmijën për pozicionimin në mënyrë korrekte të objekteve mbi një sipërfaqe (puna me model).– të përkujdeset për përdorimin nga fëmija i fjalëve që

lidhen me sipërfaqen si mbi, nën etj.

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me fëmijën.
- të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për tu orientuar në hapësirë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin kohor.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për orientimin kohor.
- të përzgjedhë mjetet e duhura për ushtrimin e fëmijës për orientimin kohor.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ushtrojë fëmijën për orientimin në kohë (para/ tani/ pastaj).
- të ushtrojë fëmijën për orientimin gjatë ditës (mëngjes, mesditë, pasdite, mbrëmje etj).
- të ushtrojë fëmijën për orientimin me ditët e javës.
- të ushtrojë fëmijën për vendosjen e një ngjarje në lidhje me dje/ sot/ nesër.
- të ushtrojë fëmijën për vendosjen e një ngjarje në lidhje me muajt.
- të ushtrojë fëmijën për orientimin sipas stinëve.
- të ushtrojë fëmijën të njohë orën.
- të mbajë shënimet e duhura lidhur me ushtrimin e fëmijës për orientimin kohor.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për tu orientuar në kohë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin me ritmin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për orientimin me ritmin.
- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen për ushtrimin e fëmijës për orientimin me ritmin.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ushtrojë fëmijën të godas sipas ritmit të tij.
- të ushtrojë fëmijën të godas sipas një ritmi të dhënë.
- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë një strukturë ritmike të

thjeshtë me ndihmën e një materiali duke alternuar dy elemente.

- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë një strukturë ritmike komplekse me ndihmën e një materiali duke alternuar tri elemente.
- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë në mënyrë grafike një strukturë ritmike.
- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë një kadencë.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijëin
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për orientimin me ritmin.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinet në shkollë ose në çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale pediatrike etj.
- Mësuesi/Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të të ushtrimit të fëmijës për orientimin në hapësirë, në kohë dhe me ritmin. Gjithashtu, duhet të demonstrojë procedurat për ushtrimin e fëmijëve për orientimin në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer orientimin e fëmijës në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskotojnë mbi orientimin e fëmijës në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përkujdesjes në sëmundje infektive.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kabinet/Klasë
 - Çerdhe
 - Kopshte fëmijësh
 - Spitale pediatrike etj.
 - Pajisjet, mjetet ndihmese dhe artikujt të nevojshëm për orientimin e fëmijës në hapësirë dhe në kohë.
 - Fëmijë.
 - Udhëzuesa, CD, rregullore, manualë, fatura financiare etj.
-

2. Moduli “Përkujdesja për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR ZHVILLIMIN E SJELLJES SHOQËRORE DHE TË AUTONOMISË SË FËMIJËS	M-20-874-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për zhvillimin e qëndrimit të fëmijës ndaj të tjerëve, ushtrimin e fëmijës për tu ushqyer dhe veshur vetë, ushtrimin e fëmijës për përkujdesjet higjienike, si dhe për të kryer llogatitje të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përkujdeset për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse të përkujdesjes për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve.- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve.- të përkujdeset që fëmija të shprehë interes ndaj njerëzve dhe mjedisit që e rrethon.- të përkujdeset për fëmijën kur ai kërkon të tërheqë vëmendjen drejt tij.- të ndihmojë fëmijën në thënien e emrit të tij.- të përkujdeset që fëmija të shprehë në mënyrë të përshtatshme dashurinë e tij.- të ndihmojë në ushtrimin e aktiviteteve në shoqëri me të tjerët.- të ushtrojë fëmijën për të përshëndetur në mënyrë të përshtatshme.- të përkujdeset që fëmija të shprehë në mënyrë të përshtatshme agresivitetin e tij.- të ndihmojë fëmijën në pranimin e ndryshimeve dhe të papriturave.- të përkujdeset që fëmija të ofrojë ndihmën spontane për të tjerët.- të edukojë tek fëmija respektimin e të tjerëve.	

-
- të edukojë tek fëmija bashkëpunimin me të tjerët.
 - të ushtrojë fëmijën për të evituar rrezikun.
 - të ushtrojë fëmijën për të treguar moshën dhe adresën e tij.
 - të ushtrojë fëmijën për të mbyllur dyert dhe dritaret.
 - të ndihmojë fëmijën të lëvizë dhe të orientohet në ndërtesë.
 - të përkujdeset për fëmijën që ai të lëvizë dhe të orientohet tek fqinjët.
 - të ushtrojë fëmijën për kujdesin gjatë qarkullimit në rrugë.
 - të ushtrojë fëmijën në blerjen në dyqan/në treg.
 - të hedhë në kartelë informacionin e duhur lidhur me fëmijën.
 - të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
 - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për qëndrimin e fëmijë ndaj të tjerëve.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi ushtron fëmijën për tu ushqyer dhe veshur vetë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për tu ushqyer dhe veshur vetë.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për ushtrimin e fëmijës për tu ushqyer dhe veshur vetë.
- të sigurojë vendin ku do të ushtrohet fëmija për tu ushqyer dhe veshur vetë.
- të ushtrojë fëmijën për ngrënien me lugë.
- të ushtrojë fëmijën për pirje me gotë.
- të ushtrojë fëmijën për ngrënien me pirun.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e thikës për të prerë.
- të ushtrojë fëmijën për përgatitjen e pijes për ta marrë me vete.
- të ushtrojë fëmijën për përgatitjen e tryezës.
- të ushtrojë fëmijën për ngrënien në tavolinë.
- të ushtrojë fëmijën për shërbimin në tavolinë.
- të përkujdeset për ruajtjen e pastërtisë gjatë të ngrënit.
- të ushtrojë fëmijën për zhveshjen/veshjen.
- të ushtrojë fëmijën për mbathjen/zbathjen e këpucëve.
- të ushtrojë fëmijën për lidhjen e këpucëve.
- të ndihmojë fëmijën në mbërthimin e kopsave, rripave.
- të plotësojë
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për tu ushqyer dhe veshur vetë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën për përkujdesjen higjienike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës në përkujdesjen higjienike.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për ushtrimin e fëmijës në përkujdesjen higjienike.
- të sigurojë vendin ku do të ushtrohet fëmija për përkujdesjen higjienike.
- të ushtrojë fëmijën për të treguar kur është i lagur/i djersitur.
- të ushtrojë fëmijën për kryerjen e nevojve në tualet në vendin e duhur/WC.
- të ushtrojë fëmijën për të shkuar ose për të kërkuar për të vajtur në banjë.
- të ushtrojë fëmijën për larjen e duarve (pasi ka shkuar në WC, para ngrënies).
- të ushtrojë fëmijën për larjen e dhëmbëve.
- të ushtrojë fëmijën për të bërë banjë.
- të ushtrojë fëmijën për veshjen dhe zhveshjen në WC.
- të ushtrojë fëmijën të krihet.
- të edukojë dhe ushtrojë fëmijën për fshirjen e hundëve.
- të ushtrojë fëmijën për prerjen e thonjëve.
- të edukojë fëmijën për kujdesin dhe autonominë në higjienën e menstruacioneve.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të plotësojë saktë faturën financiare shërbimin e kryer.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës në përkujdesjen higjienike.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi banimi etj.
- Mësuesi/Instruktori dhe personeli duhet të demostrojë qartë përkujdesjen për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve, për ushtrimin e fëmijës të ushqehet dhe të vishet vetë, për ushtrimin e fëmijës në përkujdesjen higjienike si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me shërbimin e kryer.
- Nxënësit duhet të angazhohen në sa më shumë veprimtari konkrete punë në përkujdesjen për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve, për ushtrimin e fëmijës të ushqehet dhe të vishet vetë, për ushtrimin e fëmijës në përkujdesjen higjienike, fillimisht në mbkëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të praktikohen edhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me shërbimin e kryer.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë mbi përkujdesjen për qëndrimin e fëmijës ndaj të tjerëve, për ushtrimin e fëmijës të ushqehet dhe të vishet vetë, për ushtrimin e fëmijës në

përkujdesjen higjienike.

- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë edhe përdorimin e veglave, mjeteve dhe materialeve që përdoren për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe autonomisë të fëmija, si dhe zbatimin e rregullave të higjienës personale dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive praktike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kujdesi social-shëndëtsor, spitale, shtëpi për fëmijë etj.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për përkujdesje dhe artikuj sanitarë.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë
 - Paisje për të realizuar ushqyerjen e fëmijës, simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
 - Udhëzues, CD, rregullore etj.
-

3. Moduli “Përkujdesja për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit të fëmija”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR ZHVILLIMIN E TË FOLURIT DHE KOMUNIKIMIT TE FËMIJA	M-20-878-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm, të komunikimit verbal dhe joverbal të fëmija.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e të folurit të kuptueshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm.- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm të fëmija.- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.- të ushtrojë fëmijën të reagojë ndaj emrit të vet.- të ushtrojë fëmijën të japë ose tregojë objekte sipas kërkesës.- të ushtrojë fëmijën të zbatojë udhëzime të thjeshta.- të ushtrojë fëmijën të formojë fjali të thjeshta.- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë histori të thjeshta.- të ushtrojë fëmijën të formojë fjali negative.- të ushtrojë fëmijën të përdorë përemrat.- të ushtrojë fëmijën të formojë fjali pyetëse.- të ushtrojë fëmijën të përdorë mënyrën kushtore të foljes.- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me fëmijën.- të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për zhvillimin e aftësisë së të folurit të kuptueshëm. Instrumentat e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli

RM2 Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e komunikimit verbal.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e komunikimit verbal.
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e komunikimit verbal të fëmija.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ndihmojë fëmijën në emetimin e tingujve.
- të ndihmojë fëmijën në përgjigjen me zë kur është i stimuluar.
- të ushtrojë fëmijën për rishqiptimin e rrokjeve.
- të ushtrojë fëmijën për rishqiptimin e fjalëve të identifikueshme.
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e "po" dhe "jo".
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e zhargonit.
- të ushtrojë fëmijën në emërtimin e disa objekteve të njohura.
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me fjalë dhe fjali.
- të ndihmojë fëmijën në formulimin e pyetjeve.
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me fjali të shkurtra.
- të ushtrojë fëmijën për tregimin e ngjarjeve.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin në mënyrë korrekte të përemrave.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin në mënyrë korrekte të kohëve të foljeve.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e mbiemrave.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e parafjalëve.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e fjalive të varura.
- të ushtrojë fëmijën për të shprehur në mënyrë të qartë.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës në zhvillimin e komunikimit verbal.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e komunikimit joverbal.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e komunikimit joverbal.

- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e komunikimit joverbal te fëmija.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të vlerësojë reagimin e fëmijës ndaj të prekurit dhe gudulisjes.
- të vlerësojë kuptimin e situatave nga fëmija, bazuar në lidhjen e objekteve me veprimin (pjetë – të ngrënit).
- të vlerësojë bërtitjen e fëmijës kur kërkon diçka/ dikë.
- të vlerësojë reagimin e fëmijës në mënyrë të përshtatshme ndaj mimikave.
- të ushtrojë fëmijën në shikimin e një objekti /një personi që i tregohet.
- të ushtrojë fëmijën në kuptimin e gjesteve të thjeshta.
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e mimikës për të shprehur emocionet e tij.
- të ndihmojë fëmijën të shprehë “po/jo” me kokë ose me gjeste.
- të ushtrojë fëmijën në tregimin me gisht.
- të ushtrojë fëmijën të përshëndesë me dorë.
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me gjeste.
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me ndihmën e figurave.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës në zhvillimin e komunikimit joverbal.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në konsultore fëmijësh, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi banimi për përkujdesjen, edukimin dhe ushtrimin e të folurit dhe të komunikimit.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet demonstrojë korrektësi veprimtaritë dhe procedurat e ushtrimit të të folurit dhe komunikimit te fëmija.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike për ushtrimin e të folurit të kuptueshëm dhe komunikimit verbal dhe jo verbal te fëmija, fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë mbi zhvillimin e të folurit të kuptueshëm, komunikimit verbal dhe joverbal te fëmija.
- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë edhe përdorimin e veglave, mjeteve dhe materialeve që përdoren për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm, komunikimit verbal dhe joverbal te fëmija, kryejnë e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to, si dhe zbatimin e rregullave të higjienës personale dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive praktike.

-
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të nxënësve.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kujdesi social-shëndëtsor, spitale, shtëpi për fëmijë etj.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për përkujdesje dhe artikuj sanitarë.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë
 - Pajisje për të realizuar zhvillimin e të folurit të kuptueshëm të fëmijës, simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
 - Udhëzues, CD, rregullore etj.
-

4. Moduli “Përkujdesja ndaj fëmijës së sëmure”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA NDAJ FËMIJËS SË SËMURË	M-21-1645-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen ndaj fëmijës së sëmure, për të ndihmuar teknikisht gjatë vizitave mjekësore dhe ekzaminimeve, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	87 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përkujdeset për fëmijën e sëmure. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse të përkujdesjes për fëmijën e sëmure;- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës së sëmure;- të kryejë me kujdes mbikqyrjen e fëmijës së sëmure.- të vëzhgojë ngjyrën e lëkurës.- të evidentojë prezencën e shenjave të alarmit.- të matë frekuencën respiratore gjatë një minute.- të matë ritmin e zemrës.- të shënojë në kartelë rezultatet e vëzhgimeve.- të informojë mjekun për rezultatet e vëzhgimeve.- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me mjekun dhe kolegët.- të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes për fëmijën e sëmure. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli <p>RM 2 Nxënësi ndihmon teknikisht gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ndihmimin gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve.	

- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës së sëmurë;
- të kryejë me kujdes mbikqyrjen e fëmijës së sëmurë.
- të ndihmojë teknikisht për mbajtjen e fëmijës gjatë vizitës.
- të parapërgatitë materialet për realizimin e procedurave;
- të mbajë fëmijën në pozicionin e duhur për ekzaminim faringeal;
- të mbajë fëmijën në pozicionin e duhur për ekzaminim torakal;
- të masë shenjat vitale (temperaturën etj);
- të plotësojë formularën përkatës me vlerat e konstatuara.
- të kontrollojë peshën e fëmijës .
- të ndihmojë infermierin në vlerësimin neurologjik .
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm me fëmijën, mjekun dhe kolegët.
- të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë dhënies së ndihmës teknike në vizitën mjeksore dhe ekzaminimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi përkujdeset për fëmijën me çrregullime të tretjes dhe nga pickime të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të realizuar përkujdesjen
- të përzgjedhë mjetet e duhura për të realizuar përkujdesjen.
- të përkujdeset për fëmijët me diarre.
- të kryej parandalimin e diarreve.
- të përkujdeset për fëmijët me dehidrim.
- të vlerësojë shkallën e dehidrimit.
- të marrë masa për rehidrimin e fëmijës.
- të përkujdeset për fëmijët me të vjella.
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime kronike të ushqyerjes.
- të vlerësojë konstipacionin.
- të shënojë në dosje të gjitha të dhënat si sasia, shpejtësia, vecoritë e jashtëqitjes.
- të përkujdeset për fëmijët me stomatit dhe kandidoz orale.
- të vëzhgojë fëmijën për praninë e simptomave të tilla si: dhimbje barku, të prera, të vjella.
- të kontrollojë elasticitetin e lëkurës.
- të ndihmojë infermierin në marrjen e analizave si: gjak venoz për elektrolit, azotemi, glicemi, urokulturë dhe koprokulturë.
- të parandalojë dëmtimin e lëkurës.

- të përkujdeset për fëmijët obez.
- të zbatojë dietën ushqimore.
- të vlerësojë aktivitetin fizik.
- të japë ndihmën e parë në rast pickimi nga gjarpëri dhe insektet.
- të parandalojë helmimet nga substanca të ndryshme.
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime të tretjes dhe nga pickime të ndryshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të realizuar përkujdesjen.
- të përkujdeset për fëmijët me Rakit (mungesën e vitaminës D).
- të informojë familjarët për rëndësinë e marrjes së vitaminave.
- të ekspozojë fëmijën në diell në orët e para të mëngjesit (07-09) dhe pasdite në orët (17-19).
- të informojë prindërit për qëndrimin e fëmijës në pozicion të përshtatshëm trupor për të parandaluar deformimin e kockave.
- të aplikojë vitaminën D sipas porosisë së mjekut.
- të përkujdeset për simptomat akute të tepicës së vitaminës D si :të vjellat, dehidrimi, temperatura, krampet abdominale, dhimbjet e kockave, konvulsionet dhe komën.
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime të tiroides.
- të vlerësojë shenjat e kreatinizmit.
- të menaxhojë trajtimin medikamentoz i cili vazhdon 8 muaj deri në 2 vjet.
- të informojë familjarët për rëndësinë e aplikimit të terapisë.
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime kockore.
- të ndihmojë fëmijët me osteomielit.
- të përkujdeset për fëmijët me artrit rheumatoid juvenil.
- të reduktojë inflamacionin dhe preventimin e deformimit të kockave të prekura.
- të përkujdeset për fëmijën me trupa të huaj në hundë.
- të përgatit mjetet e nevojshme .
- të pozicionojë fëmijën duke e mbajtur të fiksuar për të kryer heqjen e trupit të huaj.

- të përkujdeset për fëmijën me trup të huaj në vesh të pozicionuar për të kryer procedurën e heqjes së trupit të huaj.
- të japë ndihmën e parë në epistaksis.
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve për fëmijët me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me çrregullime të sistemit të frymarrjes dhe të aparatit kardio-vaskular.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të realizuar përkujdesjen tek fëmijët me çrregullime të sistemit tretës dhe atij kardio-vaskular.
- të përkujdeset për fëmijët me laringit.
- të përkujdeset për fëmijët më trakeit.
- të kryejë përkujdesjen për fëmijët me sëmundje të rrugëve respiratore si: bronkit, bronkiolit.
- të përkujdeset për fëmijën me pneumoni.
- të përkujdeset për fëmijët me bronkopneumoni.
- të masë frekuencën respiratore dhe të ruajë funksionin optimal respirator.
- të bëjë rregullisht matjen e temperaturës për të parandaluar konvulsionet febrile.
- të kryejë aspirimin e sekrecioneve çdo 4 orë për të parandaluar bllokimet e mundshme.
- të përkujdeset për fëmijët me astmë bronkiale.
- të informojë familjarët për krizën astmatike.
- të mbrojë fëmijën nga faktorët shpërthyes të astmës bronkiale.
- të vlerësojë cilësinë e frymarrjes, nëse fëmija ka gulcim, nëse zëri është i çrjerrët, zhurmat respiratore, rrahjet e zemrës dhe elasticitetin e lëkurës.
- të përkujdeset për fëmijët e prekur nga ethja reumatizmale.
- të parandalojë sëmundjet si tonsilit, faringit dhe skarlatinën që çojnë në ethen reumatizmale.
- të aplikojë terapinë e caktuar nga mjeku.
- të poziciojë fëmijën në pozicion të përshtatshëm për të lehtësuar dhimbjet.
- të informojë familjarët për administrimin e medikamenteve, përlllogaritjen e tyre si dhe shenjave që tregojnë keqësim të gjendjes së tyre si: ushqyerje me vështirësi, irritim , gjendje gjumi, edemë rreth syve dhe ekstremiteteve.
- të masë rregullisht pulsën dhe të raportojë për ndryshimet.
- të ruajë higjienën e lartë të gojës dhe të dhëmbëve.

- të shënojë në kartelë të gjitha procedurat e realizuara.
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve për fëmijët me çrregullime të sistemit të frymarrjes dhe të aparatit kardio-vaskular.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Nxënësi përkujdeset për fëmijën me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar.

Kriteret e vlerësimit:

- ***Nxënësi duhet të jetë i aftë:***

- të përkujdeset për fëmijët me anemi.
- të kryejë përkujdesjen në aneminë nga mungesa e Fe.
- të marrë masa për eliminimin e shkaqeve të anemisë.
- të zbatojë dietën ushqimore në një fëmijë anemik.
- të përkujdeset në dhënien e vitaminës B₁₂, acidit folik dhe ferro-sulfatit.
- të ndërgjegjësojë familjarët për korrigjimin e anemisë.
- të përkujdeset për fëmijët në hemofili.
- të vlerësojë hemoragjinë tek fëmijët me hemofili.
- të përkujdeset për fëmijët me leucemi.
- të asistojë në ekzaminime.
- të përkujdeset për fëmijën me infeksionet e rrugëve urinare.
- të përkujdeset për fëmijën me enurezis nikturua.
- të orientojë familjarët për trajtimin e enurezis nikturua.
- të përkujdeset për fëmijën në sindromin nefrotik.
- të shënojë të gjithë të dhënave në dosjen e fëmijës.
- të përkujdeset për fëmijët me insufiçencë renale akute.
- të monitorojë diurezën.
- të përkujdeset për fëmijët me gromerulonefrit akut (post streptokoksik).
- të monitorojë shenjatat vitale dhe bilancin elektrolit-lëngje për të vlerësuar funksionin renal.
- të shënojë në kartelë të gjitha procedurat e realizuara.
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes të fëmijës me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në spitale pediatrike, qendra shëndetësore, konsultore fëmijësh, shtëpi banimi për të realizuar kujdesin, mbikqyrjen e fëmijës së sëmurë dhe administrimin e barnave.
- Mësuesi/instruktori apo personeli shëndetësor duhet të

përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të përkujdesjes, mbikqyrjes së fëmijës së sëmurë.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete sa më shumë të jetë e mundur për të realizuar kujdesin, mbikqyrjen e fëmijës së sëmurë, përkujdesjen ndaj fëmijëve me me çrregullime të tretjes dhe nga pickime të ndryshme, me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj, me çrregullime të sistemit të frymarrjes dhe të aparatit kardio-vaskular, me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar, fillimisht në mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të parimeve të etikës dhe të sjelljes profesionale në shërbimin pediatrik, si dhe ato të komunikimit me etikë dhe profesionalizëm.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përkujdesjes për fëmijën e sëmurë.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, njerëzit në nevoje, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- Spitale pediatrik, qendra shëndetësore, konsultore fëmijësh, shtëpi banimi etj.
 - Formularë të përgatitur përkatësisht për kujdesin, mbikqyrjen e fëmijës së sëmurë dhe administrimin e barnave.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Shtrat mjekësor.
 - Tabaka për dhënien e medikamenteve.
 - Doreza.
 - Kosh për hedhjen e mbeturinave .
 - Materiale të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
 - Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

5. Moduli “Përkujdesja gjatë dhënies së medikamenteve në rrugë të ndryshme”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA GJATË DHËNIES SË MEDIKAMENTEVE NË RRUGË TË NDRYSHME	M-21-1646-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për administrimin e medikamenteve, dozimin e tyre dhe aplikimin e terapisë, përkujdesjen gjatë dhënies së medikamenteve si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi dozon medikamentet sipas formulave pediatrike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse (doreza) për dozimin e medikamenteve. - të përzgjedhë mjetet e duhura për dozimin e medikamenteve - të respektojë rregullat e dozimit të medikamenteve. - të zbatojë formulat standarde për llogaritjen e dozave në pediatri. - të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë dozimit të medikamenteve. <p>Instrumentat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli <p>RM 2 Nxënësi përkujdeset në dhënien e medikamenteve të urgjencës.(për këtë është fjala???) Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për administrimin e medikamenteve. - të respektojë 5 rregullat D në administrimin e medikamenteve. - të respektojë urdhrin e mjekut për administrimin e medikamenteve. - të lexojë fletën udhëzuese para administrimit të medikamenteve. 	

- të respektojë rregullat e administrimit të medikamenteve.
- të lexojë fletën udhëzuese para administrimit të medikamenteve.
- të aplikojë medikamentet e urgjencës.
- të ndërhyjë në rast reaksioni alergjik.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë aplikimit të medikamenteve e urgjencës.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi i jep fëmijës medikamente në rrugë të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për zbatimin e të gjitha rrugëve të marrjes së medikamenteve. të përzgjedhë mjetet/sendet e duhura për rrugët e marrjes së medikamenteve.
- të zbatohet urdhëri i mjekut për terapinë.
- të pozicionojë fëmijën sipas rrugës që do i jepet medikamenti.
- të qetësojë fëmijën gjatë procedurës.
- të zbatojë rrugën e dhënies së medikamentit të përshkruar në recetë.
- të pozicionojë fëmijën për administrimin oral të medikamenteve
- të japë ujë ose lëngje para dhe gjatë marrjes së medikamentit nga goja.
- të qëndrojë afër fëmijës deri sa të gëlltisë medikamentin.
- të vëzhgojë fëmijën për ndonjë veprim anësor serioz të medikamentit.
- të asistojë në administrimin e medikamentit në rrugë intravenoze.
- të zbatojë të gjitha procedurat e injektimit intravenoz.
- të pozicionojë fëmijën për aplikim të medikamenteve intramuskulare dhe subkutan.
- të përcaktojë vendet për aplikimin intramuskular dhe subkutan.
- të ruajë sterilitetin gjatë aplikimeve.
- të vëzhgojë fëmijën për reaksione anafilaktike.
- të plotësojë dokumentacionin e duhur për shërbimin e kryer.
- të plotësojë saktë faturën financiare të shërbimit të kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë dhënies së medikamenteve në rrugë të ndryshme të fëmija.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi banimi etj.
- Mësuesi/Instruktori dhe personeli duhet të demonstrojë sa më shumë veprimtaritë praktike të përkujdesjes në dhënien e medikamenteve në rrugë të ndryshme të fëmija.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë e mundur në dhënien e medikamenteve në rrugë të ndryshme të fëmija, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë mbi mënyrat e dhënies së medikamenteve fëmijëve të sëmurë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijëve në dhënien e medikamenteve në rrugë të ndryshme.
- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë përdorimin e mjeteve apo pajisjeve për dhënien e medikamenteve në rrugë të ndryshme, si dhe zbatimin e rregullave të higjienës personale dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dhënies së medikamenteve fëmijëve të sëmurë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi për fëmijë etj.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për përkujdesje dhe artikuj sanitarë.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të dhënies së medikamenteve në rrugë të ndryshme.
 - Udhëzues, CD, rregullore etj.
-

4. Moduli “Përkujdesja ndaj fëmijës me sëmundjet infektive dhe parazitare”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	PËRKUJDESJA NDAJ FËMIJËS ME SËMUNDJET INFEKTIVE DHE PARAZITARE	M-21-1647-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për evidentuar simptomat e sëmundjeve infektive dhe parazitare, për tu përkujdesur ndaj këtyre sëmundjeve, zbatimin e rregullave aseptike për parandalimin e infektimit tek të tjerët, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me infeksione virale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse gjatë përkujdesjes ndaj fëmijës me infeksione virale.- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës me infeksione bakteriale.- të identifikojë simptomat e varicelës, gripit epidemik, parotiti dhe fruthit.- të vlerësojë përgjigjësinë për higjienën dhe përkujdesjet mjekësore në infeksionet virale.- të përkujdeset për lekuren e fëmijës në varësi të infeksionit.- të identifikojë simptomat alarmuese që paralajmërojnë komplikacione.- të informojë dhe këshillojë prindërit për natyrën e infeksionit.- të respektojë sekretin profesional.- të zbatojë rregullat e asepsisë për parandalimin e infeksioneve tek fëmijët .- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.- të zbatojë rregullat e higjienës personale.- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve ndaj fëmijëve të sëmurë me infeksione virale. Instrumentat e vlerësimit:	

-
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi përkujdeset për fëmijët në infeksionet bakteriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për përkujdesjen ndaj fëmijës me infeksione bakteriale.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës me infeksione bakteriale.
- të identifikojë simptomat e pneumonisë, pertusit, shigelës, salmonelës dhe meningitit.
- të parandalojë grumbullimin e sekrecioneve duke përdorur teknikën e aspirimit.
- të pozicionojë fëmijën në rast të kollës dhe vështirësisë në frymemarrje.
- të ndihmojë në pozicionimin e fëmijës gjatë ekzaminimeve diagnostikuese.
- të identifikojë simptomat alarmante që paralajmërojnë komplikacione.
- të informojë prindërit dhe familjarët për rëndësinë e vaksinimit.
- të krijojë një klimë respekti dhe mirëbesimi reciprok me fëmijët.
- të ndërtojë marrëdhënie të ngoshta me familjarët e fëmijëve.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve ndaj fëmijës me infeksione bakteriale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi përkujdeset për fëmijët në infeksionet parazitare.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për përkujdesjen ndaj fëmijës me infeksione parazitare.
- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës me infeksione parazitare.
- të identifikojë simptomat e infeksioneve parazitare.
- të përkujdeset për fëmijën me diarre.
- të parandalojë dehidrimin e fëmijës.
- të informojë prindërit dhe familjarët për natyrën e infeksioneve parazitare.
- të informojë prindërit për respektimin e normave të higjienës vetjake dhe kolektive.
- të ndihmojë në kryerjen e procedurave për ekzaminimet diagnostikuese.

- të identifikojë simptomat specifike që paralajmërojnë komplikacione të infeksioneve parazitare.
- të parandalojë transmetimin e infeksioneve tek fëmijët.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjes për fëmijën me infeksione parazitare.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa teorie, në çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale pediatrike etj.
- Mësuesi/Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për diagnostikimin e infeksioneve virale, bakteriale dhe parazitare, për aspirimin e sekrecioneve etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer përkujdesjen në infeksionet virale, bakteriale dhe parazitare, përkujdesjen për parandalimin e komplikacioneve dhe respektimin e rregullave të higjienës, si një faktor kryesor në parandalimin e infeksioneve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë demonstrimit praktik .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përkujdesjes në sëmundjet infektive.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klase-teorie, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale pediatrike etj.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Mjete të tjera (shtrat mjekësor, jastek për pozicionimin e femijës, aparat aspirimi për sekrecionet, mjete të ndryshme për marrjen e mostrave ekzaminuese, materiale për mbajtjen e higjienës) për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë.
 - Udhëzuesa, CD, rregullore etj.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Ndhimja ndaj fëmijës gjatë procesit të të mësuarit”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NDIHMA NDAJ FËMIJËS GJATË PROCESIT TË TË MËSUARIT	M-20-879-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për të ndihmuar fëmijët gjatë procesit të të shkruarit, të të lexuarit, si dhe të kryerjes së veprimeve matematikore, si dhe për të kryer llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi ndihmon fëmijën gjatë të shkruarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të të shkruarit. - të përzgjedhë mjetet/sendet/materialët e duhura për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të të shkruarit. - të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija në të shkruar. - të ndihmojë fëmijën të shkarravisë lirshëm me laps. - të ndihmojë fëmijën të shkarravisë lirshëm me një furçë. - të ndihmojë fëmijën të ngjyrosë duke respektuar konturet. - të ndihmojë fëmijën të riprodhojë me një figurë të thjeshtë (të rrumbullakët, katrore). - të ndihmojë fëmijën të bashkojë pikat horizontale, vertikale, të pjerrëta. - të ndihmojë fëmijën të riprodhojë një vizatim të thjeshtë (shtëpi, pemë) - të ndihmojë fëmijën të vizatojë në mënyrë spontane objekte të njohura (shtëpi, pemë, makinë, etj.). 	

- të ndihmojë fëmijën të vizatojë gjysëm-rrathë dhe rathë.
- të ndihmojë fëmijën të vizatojë vija vertikale dhe horizontale.
- të ndihmojë fëmijën të shkruajë emrin e tij.
- të ndihmojë fëmijën të kopjojë shkronja dhe shifra.
- të ndihmojë fëmijën të shkruajë shkronja dhe shifra duke ia diktuar.
- të ndihmojë fëmijën të shkruajë disa fjalë.
- të ndihmojë fëmijën në përdorimin e të shkruarit të lidhur.
- të ndihmojë fëmijën të shkruajë fjalë që i diktohen.
- të ndihmojë fëmijën të formulojë një tekst të thjeshtë.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë dhënies së ndihmës në të shkruar, fëmijës.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi ndihmon fëmijën gjatë të lexuarit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të të lexuarit.
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të të lexuarit.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija në të lexuar.
- të ndihmojë fëmijën në identifikimin e disa shkronjave.
- të ndihmojë fëmijën të njohë emrin e tij të lexuar në global.
- të ushtrojë fëmijën bashkimin e shkronjave dhe tingujve.
- të ndihmojë fëmijën në shqiptimin e rrokjeve.
- të ushtrojë fëmijën në bashkimin e një fjale me një figurë.
- të ndihmojë fëmijën të lexojë një paragraf.
- të ushtrojë fëmijën në bashkimin e një fjalie me një figurë.
- të ushtrojë fëmijën në leximin e disa fjalive të thjeshta.
- të ushtrojë fëmijën në leximin e teksteve të shkurtra.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë dhënies së ndihmës në të lexuar, fëmijës.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën për kryerjen e veprimeve matematikore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të kryerjes së veprimeve matematikore.
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për të ndihmuar fëmijën gjatë procesit të kryerjes së veprimeve matematikore.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija në kryerjen e veprimeve matematikore.
- të ushtrojë fëmijën të numërojë deri në 10.
- të ushtrojë fëmijën të numërojë objekte të renditura.
- të ushtrojë fëmijën të klasifikojë objektet sipas një kriteri.
- të ushtrojë fëmijën të numërojë objekte që janë të vendosura në mënyrë të çrregullt.
- të ushtrojë fëmijën të gjejë karakteristikën e përbashkët të elementeve të një bashkësie.
- të ushtrojë fëmijën të klasifikojë objekte sipas karakteristikave të tyre.
- të ushtrojë fëmijën të vendosë lidhjet krahasimore (me shumë / më pak /aq sa).
- të ushtrojë fëmijën të gjejë shumën e disa objekteve.
- të ushtrojë fëmijën të gjejë shumën e disa numërorëve.
- të ushtrojë fëmijën të njohë shifrat nga 1 deri në 20.
- të ushtrojë fëmijën të lexojë dhe të shkruajë datën.
- të ushtrojë fëmijën të gjejë numrin e elementeve të një bashkësie.
- të ushtrojë fëmijën të ndajë shifrat sipas rrethësive të përbashkëta të një numëror shumëshifror.
- të ushtrojë fëmijën të kryejë veprimin e zbritjes së disa objekteve.
- të ushtrojë fëmijën të kryejë veprimin e zbritjes së disa numërorëve.
- të ushtrojë fëmijën të numërojë deri në 100.
- të ushtrojë fëmijën të përdorë saktë monedhat dhe kartmonedhat.
- të ushtrojë fëmijën të njohë shifrat mbi 20.
- të ushtrojë fëmijën të përdorë vizoren dhe metrin.
- të ushtrojë fëmijën të numërojë me rend zbritës.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë dhënies së ndihmës në kryerjen e veprimeve matematikore.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në kopshte fëmijesh, shkolla dhe shtëpi banimi për edukimin e të mesuarit në shkollë.
- Mësuesi/Instruktori dhe personeli shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi veprimtaritë praktike për të ndihmuar

fëmijët gjatë procesit të të shkruarit, të të lexuarit, si dhe të kryerjes së veprimeve matematikore.

- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete praktike për të ndihmuar fëmijët gjatë procesit të të shkruarit, të të lexuarit, si dhe të kryerjes së veprimeve matematikore, fillimisht të mbikëqyrur dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë mbi zhvillimin e aftësisë për të ndihmuar fëmijët gjatë procesit të të shkruarit, të të lexuarit, si dhe të kryerjes së veprimeve matematikore.
- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë përdorimin e mjeteve dhe materialeve për zhvillimin e aftësisë për të ndihmuar fëmijët gjatë procesit të të shkruarit, të të lexuarit, si dhe të kryerjes së veprimeve matematikore, zbatimin e rregullave të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me veprimtaritë përkatëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Kopshte fëmijësh, shkolla dhe shtëpi banimi etj.
 - Fëmijë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme
 - Formularë të përgatitur përkatësisht për edukimin e të mësuarit në shkollë të fëmijës.
 - Mjete kancelarie, fatura financiare etj.
-

2. Moduli “Përkujdesja për motoricitetin e përgjithshëm, skemës trupore dhe motoricitetin fin të fëmijës”.

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	PËRKUJDESJA PËR MOTORICITETIN E PËRGJITHSHEM, SKEMËN TRUPORE DHE MOTORICITETIN FIN TË FËMIJËS	M-21-875-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesje për motoricitetin e përgjithshëm, ushtrimin e fëmijës në njohjen e skemës trupore, si dhe për motoricitetin fin të fëmijës.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ushtron fëmijën për motoricitetin e përgjithshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për përkujdesjen ndaj fëmijës për motoricitetin e përgjithshëm. - të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës për motoricitetin e përgjithshëm . - të sigurojë vendin ku dotë ushtrohet fëmija. - të ushtrojë fëmijën të vendoset, sipas kërkesës, në pozicione të ndryshme (i ulur, këmbadorazi, në këmbë) - të ushtrojë fëmijën të ecë. - të ushtrojë fëmijën për lëshimin/pritjen e topit. - të ushtrojë fëmijën për ngjitjen/zbritjen e shkallëve. - të ushtrojë fëmijën në ngjitjen/zbritjen e shkallëve duke alternuar këmbët. - të ushtrojë fëmijën gjatë vrapimit. - të edukojë fëmijën për marrjen pjesë aktive në një aktivitet sportiv të grupit (vallëzim, futboll etj.). - të ushtrojë fëmijën për kërcime dhe hedhje. - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me fëmijën. - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve ndaj fëmijës për motoricitetin e përgjithshëm. 	

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi ushtron fëmijën në njohjen e skemës trupore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për përkujdesjen ndaj fëmijës për njohjen e skemës trupore.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për kujdesin ndaj fëmijës për njohjen e skemës trupore .
- të sigurojë vendin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ushtrojë fëmijën për të treguar tek vetja të pjesët kryesore të trupit.
- të ushtrojë fëmijën për të treguar tek dikush tjetër pjesët kryesore të trupit.
- të ushtrojë fëmijën për të emërtuar pjesët kryesore të trupit.
- të ushtrojë fëmijën për të vizatuar pjesët kryesore të trupit.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përkujdesjeve ndaj fëmijës për njohjen e skemës trupore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën për motoricitetin fin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për motoricitetin fin.
- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen për ushtrimin e fëmijës për motoricitetin fin të tilla si: objekte të vogla të ndryshme,
- të sigurojë vendin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ushtrojë fëmijën për të mbajtur në dorë një objekt.
- të ushtrojë fëmijën të përdorë gishtin e madh dhe atë tregues për të kapur një objektet.
- të ushtrojë fëmijën të manipulojë me objekte të vogla.
- të ushtrojë fëmijën për transferimin e objekteve nga një mbajtesë tek tjetra.
- të ushtrojë fëmijën të grisë një letër.
- të ushtrojë fëmijën të mbledhë grumbull disa objekte.
- të ushtrojë fëmijën të koordinojë të dy duart.
- të ushtrojë fëmijën të ndërthë (çdo të thotë kjo fjalë???) tek njëri-tjetri disa objekte.
- të ushtrojë fëmijën për kalimin e rruazave në një fije peri.
- të ushtrojë fëmijën të vidhosë/ç'vidhosë.
- të ushtrojë fëmijën të ngjitë.
- të ushtrojë fëmijën të kryej njëra pas tjetrës lëvizje të

ndryshme me të dy duart.

- të ushtrorë fëmijën të derdhë ujë nga një enë në një tjetër.
- të ushtrorë fëmijën të përdorë gërsërët në mënyrë korrekte.
- të ushtrorë fëmijën të presë me gërsërë në mënyrë preçize.
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës për motoricitetin fin.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi për fëmijë etj.
- Mësuesi/Instruktori dhe personeli shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektesë veprimtaritë praktike për zhvillimin e motoricitetit të përgjithshëm dhe fin të fëmijës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete praktike të përkujdesjes ndaj fëmijëve për zhvillimin e motoricitetit të përgjithshëm dhe fin të fëmijës., fillimisht të mbikëqyrur dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë mbi zhvillimin e motoricitetit të përgjithshëm dhe fin të fëmijës..
- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë përdorimin e mjeteve dhe materialeve për zhvillimin e motoricitetit të përgjithshëm dhe fin të fëmijës, zbatimin e rregullave të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me veprimtaritë përkatëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi për fëmijë etj.
 - Pajisjet dhe artikujt didaktikë të nevojshëm për ushtruar të fëmija motoricitetin e përgjithshëm, skemën trupore dhe motoricitetin fin.
 - Fëmijë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Udhëzuesat, CD, rregullore etj.
-

3. Moduli “Përkujdesja për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijës nëpërmjet shqisave”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Shërbime kujdesi për fëmijë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	PËRKUJDESJA PËR ZHVILLIMIN E AFTËSISË NJOHËSE TË FËMIJËS NËPËRMJET SHQISAVE	M-20-877-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për përkujdesjen për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijët, nëpërmjet shqisës së të parit, të dëgjuarit dhe të të prekurit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë aftësinë njohëse nëpërmjet shqisës së të parit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të parit. - të përzgjedhë mjetet/sendet e duhura për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të parit të fëmija. - të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija. - të ushtrojë fëmijën në vëzhgimin e njërezve ose sendeve. - të ushtrojë fëmijën në ndjekjen me shikim të njerëzve ose sendeve në lëvizje. - të ushtrojë fëmijën të rendisë objekte të ndryshme. - të ushtrojë fëmijën të lidhjen e objekteve / pamjeve të njëjta. - të ushtrojë fëmijën të rendisë disa pamje të ndryshme. - të ushtrojë fëmijën të tregojë objektin në një pamje komplekse. - të ushtrojë fëmijën të rendisë objekte sipas ngjyrave. - të ushtrojë fëmijën të rendisë objekte sipas formës. - të ushtrojë fëmijën të rendisë objekte sipas madhësisë. - të mësojë fëmijën të bëjë emërtimin e ngjyrave. - të mësojë fëmijën të bëjë emërtimin e formave. - të ndihmojë fëmijën të orientohet me imazhet ose simbolet. - të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën. - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit 	

gjatë zhvillimit të aftësisë njohëse te fëmija nëpërmjet të parit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë aftësinë njohëse nëpërmjet shqisës së të dëgjuarit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të dëgjuarit.
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të dëgjuarit te fëmija.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të ushtrojë fëmijën të reagojë ndaj ndryshimeve të intensitetit dhe të lartësisë.
- të ushtrojë fëmijën të njohë tingujt e jetës së përditëshme.
- të ushtrojë fëmijën të njohë të bërtiturat e kafshëve.
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e një instrumenti duke bërë të ndryshojë intensiteti.
- të ushtrojë fëmijën në imitim të tingujve të kafshëve.
- të mësojë fëmijën të njohë termat si fort, ngadalë, shumë i fortë, etj., dhe përdorimin e tyre.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën.
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zhvillimit të aftësisë njohëse nëpërmjet të dëgjuarit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë aftësinë njohëse nëpërmjet shqisës së të prekurit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jete i afte:

- të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ushtrimin e fëmijës për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të prekurit.
- të përzgjedhë mjetet/sendet e duhura për zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisës së të prekurit te fëmija.
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija.
- të mësojë fëmijën të pranojë të prekë objekte me struktura të ndryshme.
- të ushtrojë fëmijën të dallojë objekte të njohura nëpërmjet të prekurit.
- të ushtrojë fëmijën të dallojë objekte sipas formës se

tyre nëpërmjet të prekurit.

- të ushtrojë fëmijën të dallojë objektet sipas strukturës së tyre nëpërmjet të prekurit.
- të ushtrojë fëmijën të dallojë objektet sipas madhësisë së tyre nëpërmjet të prekurit.
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e termave i butë, i fortë etj.
- të plotësojë dokumentacionin e duhur për shërbimin e kryer.
- të plotësojë saktë faturën financiare të shërbimit të kryer.
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me fëmijën
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të fëmijës në zhvillimin e aftësisë njohëse nëpërmjet shqisave të të parit, të të dëgjuarit dhe të të prekurit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në spitale, shtëpi për fëmijë, shtëpi banimi ose çerdhe e kopshte.
- Mësuesi/Instruktori dhe personeli shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektesi veprimtaritë praktike për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijës nëpërmjet shqisave të të parit, të të dëgjuarit dhe të të prekurit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete praktike të përkujdesjes ndaj fëmijëve për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmijës nëpërmjet shqisave të të parit, të të dëgjuarit dhe të të prekurit, fillimisht të mbikëqyrur dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë mbi zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmija me anë të shqisave të të parit, të të dëgjuarit dhe të të prekurit.
- Mësuesi/Instruktori duhet të vëzhgojë përdorimin e mjeteve dhe materialeve për zhvillimin e aftësisë njohëse të fëmija, zbatimin e rregullave të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me veprimtaritë përkatëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Spitale, klinika, shtëpi fëmijësh, etj.
 - Formularë të përgatitur përkatësisht për kujdesin në zhvillimin e ndjeshmërisë së fëmijës, perceptimit vizual, me të prekur dhe nëpërmjet të dëgjuarit
-

-
- Fëmijë, manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme
 - Udhëzuesa, CD, rregullore, manualë, fatura financiare etj.
-